



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:261511

Datë: 04.11.2022

Numri i dokumentit: 03609014

CP.nr.1000/13

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kreditimi Rural i Kosovës-Dega në Vushtri, të cilën e përfaqëson M. J. ndaj debitorëve G. K.nga fshati M. Komuna e V. dhe B. Sh. nga fshati A. Komuna e V. duke vendosur sipas tërheqjes së kreditorit nga propozimi për përmbartim i datës 13.10.2011, jashtë seance me datë 04.11.2022 mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përmbartimore e kreditorit Kreditimi Rural i Kosovës-Dega në Vushtri, ndaj debitorëve G. K.nga fshati M. Komuna e V. dhe B. Sh. nga fshati A. Komuna e V. për sekuestrimin e objektit të pengut (kolateralit), në shumën prej 2,003.35 € (Dymijë e tri euro e tridhjetë e pesë cent), për shkak tërheqjes së propozimit nga kreditori.

A r s y e t i m

Kreditori Kreditimi Rural i Kosovës-Dega në Vushtri, me datë me datë 08.02.2009 ka parashtruar propozim për sekuestrimin e objektit të pengut (kolateralit), ndaj debitorëve G. K.nga fshati M. Komuna e V. dhe B. Sh. nga fshati A. Komuna e V.

Gjykata e ka lejuar përmbartimin me datë 03.03.2010.

Gjyqtari i çështjes është ngarkuar më këtë lëndë me datë 21.04.2022.

I autorizuari i kreditorit me parashtrësën e datës 13.10.2022, e ka njoftuar gjykatën se e tërheq propozimin për përmbarrim në këtë çështje përmbarrimore.

Gjykata, bazuar në të lartcekurat dhe konform nenit 42 par.2 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

CP.nr.1000/13, datë 04.11.2022

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi lejohet e drejta në ankesë në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.